1786 2711

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data 15.2.2021

Lënda: Kthim Përgjigje

Nr. Protokolli 1079/1

DREJTUAR: **QENDRËS "RES PUBLICA"**
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

Në përgjigje të e-mailit tuaj datë 10.02.2021, administruar me nr.1079 prot., datë 10.02.2021, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

- Referuar Modelit 06, të Udhëzimin nr. 01, datë 23.12.2020 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit", kolona dedikuar adresës shënohet specifikisht adresa e njësisë administrative ku nënshkruesi ka vendbanimin dhe jo Bashkia përkatëse.

- Në zbatim të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, administrata e KQZ-së verifikon 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Në rast se gjatë mbledhjes së nënshkrimeve, një prej nënshkruesve tërhiqet, ai nuk mund të eliminohet nga modeli 06, por mjafton të shtoni numrin e mbështetësve në listat e tjera, në mënyrë që numri i nënshkrimeve mbështetëse, të jetë të paktën sa numri minimal i kërkuar nga neni 69 i Kodit Zgjedhor.

- Dorëzimi i nënshkrimeve për kandidat të pavarur mund të kryhet edhe nga një përfaqësues i komitetit nismëtar, pa qenë e nevojshme pajisja e tij me autorizim/prokurë nga anëtarët e tjerë.

Sekretar i Përgjithshëm

Ylli MERKAJ

Rruga Ibrahim Rugova Nr. 4
Tiranë 1007, Shqipëri
www.kqz.gov.al
info@kqz.gov.al